REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës:	2019:266416
Datë:	21.01.2021
Numri i dokumentit:	01428064

A.nr.1554/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike NazifeSheholli, ne konfliktin administrativ, të paditësit NTP M. me seli në F. kundër të padituresë Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 20.01.2021, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHETKërkesëpadiae paditësit NTP M. me seli në F., si e pa bazuar.

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.07.3/77-2016 datës 23.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, në rivendosje, ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.R-249/06.01.2016 të Z.B.D. Prishtinë, si e pa bazuar.

Paditësi NTP M. me seli në F., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 01.07.2019, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të padituresë Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të aprovohet padia në tërësi si e bazuar, të anulohet aktvendimi i të padituresë nr.07.3/77-2016 datës 23.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, si dhe të obligohet Dogana e Kosovës që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit mbi vlerën e transaksionit.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaron: me anë të DUD-it kontestues të ZBD Prishtinë, importuesi ka deklaruar për doganim mallin e ndrzshëm sipas faturës dhe deklaratës doganore. E paditura ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht neni 33 te Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe neni 123 të Udhëzimit Administartiv nr.11/2009, pasi që paditësi, DUD-it kontestues i ka bashkangjitur prova relevante me qëllim të vërtetimit të çmimeve të transaksionit, përkatësisht faturën, urdhërpagesën bankare në emër të saj, si dhe kontratën për shitblerjen e mallrave, të gjitha këto të harmonizuara në kuptim të vlerës, e më e rëndësishmja nga këto urdhërpagesa bankare, e cila ka edhe numrin e faturës të paguar. Kjo lëndë është për herë të dytë në gjykatë, pasi që fillimisht gjykata e ka kthyer të njëjtin në rishqyrtim dhe rivendosje me anë të Aktgjykimit A./nr.469/16 të dt.18.03.2019. Mirëpo e paditura nuk ka marrë për bazë vërejtjet dhe rekomandimet e gjykatës duke e refuzuar përsëri kërkesën për rishqyrtim të

DUD-it kontestues. Me rastin e vendimit të atakuar konsiderojmë se e paditura ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, pasi që përgjigjes në padi nuk i ka bashkangjitur ndonjë provë me të cilën vërtetohet se paditësi ka paguar më tepër në emër të mallit lëndor, sesa vlera transaksionale e deklaruar. Rivlerësimi është mbështetur në procesin për përcaktimin e vlerës së mallit, mirëpo të njëjtit nuk i është bashkangjitur ndonjë provë me të cilën do të vërtetohej çmimi i përcaktuar nga Dogana, prandaj konsiderojmë se procesi për përcaktimin e vlerës së mallit nuk paraqet në vetëvete provë, sepse i njëjti është dokument apo veprim procedural. Se paditësi ka poseduar dhe prezantuar dokumentacion të harmonizuar në kuptim të vlerës është konstatuar edhe në Aktgjykimin e referuar më sipër, prandaj kërkoj nga gjykata që këto konstatime ti marrë për bazë me rastin e vendosjes së kësaj lënde. Duke pasur parasysh te theksuarat, edhe provat e administruara kërkojmë nga gjykata që ta vendos këtë lëndë në mënyrë meritore, ashtu që të bëj aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërsi si të bazuar duke anuluar aktvendimin e atakuar, dhe të detyroj te paditurën që ti kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të taksave doganore mbi vlerën e transaksionit në shumë prej 9,684.85 Euro, me kamatë ligjore në shkallë prej 8% nga dita e pagesës e deri në kthimin e plotë.

E paditura në përgjigje në padi datës 30.11.2020 dhe përmes të autorizuarit në seancën e shqyrtimit kryesor deklaron: se e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe ato të theksuara gjatë seance. Pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë shkelje ligjore duke mos aplikuar nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor, është kualifikim i gabuar dhe pa bazë juridike i paditësit, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave, është caktuar kompetenca e oficerëve doganor që me rastin e deklarimit të mallit të kontrollojnë dokumentacionin dhe ti shikojnë mallin e pastaj në bazë të këtyre vlerësimeve përcaktohet se a do ti pranohet vlera e transaksionit gjegjësisht aplikimi i nenit 33 ose do ti kontestohet vlera e deklaruar e importuesit e në këtë rast të paditësit. Procedura e doganimit të mallit edhe është përfillur në tërësi dhe është konstatuar se paditësi ka deklaruar mallin sipas vlerës, mirëpo e paditura ka poseduar të dhëna se për të njëjtin mall posedon vlera më të larta të çmimit. Gjithashtu, sa i përket pretendimit tjetër të shprehur nga paditësi, se në aktvendimin kontestues nuk është vërtetuar sakt gjendja faktike sepse sipas paditësit në asnjë provë nuk është konstatuar se paditësi ka paguar më tepër në emër të mallit lëndor, edhe ky pretendim është i gabuar dhe në aspektin juridik kualifikim pa bazë ligjore, sepse e paditura nuk ka filluar dhe as udhëhequr procedurë penale, sepse po të konstatohej se paditësi ka ndryshuar faturat, atëherë kjo në elementin e saj paraqet vepër penale e cila ndiqet ex-oficio si shmangie mashtruese, por e paditura vetëm ka konstatuar një gjendje faktike duke krahasuar çmimin e mallit të deklaruar dhe me të dhënat e disponueshme që i ka poseduar ajo. Andaj çmimi i mallit paditësit nuk iu është pranuar në kuptim të vlerës së mallit për qëllime të procedurës doganore. Paditësi nuk ka paraqitur as në fazën e doganimit dhe as në procedurat tjera dokument relevant siç është deklarata eksportuese. Andaj nga kjo i propozoi gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, dhe të lë në fuqi aktvendimin e kontestuar të Doganës së Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 20.01.2021, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt.30.11.2020 nga Dogana e Kosovës, aktvendimi nr.07.3/77-2016 i Doganës së Kosovës, Deklarata Doganore, fatura YËJM13450-32 dt.27.10.2015, pagesa bankare e dt.05.01.2016, Kontrata e shitblerjes së mallit e dt.27.10.2015, Urdhër Pagesa Ndërkombëtare, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave i dt.22.01.2016, Aktgjykimi A.nr.469/16, i dt.18.03.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 20.01.2021, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi,

shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka konfirmuar rivlerësimin e zyrës së pranimit qëndror për mallin lëndor të zhdoganuar me Deklaratën Unike Doganore kontestuese, duke konstatuar se zyra e pranimit ka aplikuar drejt metodën e 6 të vlerësimit nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, pasi që këto të dhëna janë marr nga Sektori i Vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke i shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë si dhe çmimet e shitjes në tregun tonë.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosove, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe te Akcizave nr. 03/L-109. Pagesa bankare e datës 05.01.2016, ProCreditBank, që gjendet në shkresat e lëndës nuk është e harmonizuar me vlerën e faturës përcjellëse të mallit doganor nr.YWJM12450-31 të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore nr.R-249/06.01.2016 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë, pasi që pagesa sipas transaksionit bankar në shumë prej 28,447.00€ ka valutën në €, ndërsa fatura e mallit ka shumën prej 28,157.70USD me shpenzimet e transportit 2,300USD gjithsejt 30,457.70USD, pra vlera e deklaruar e mallit në shumën prej 28,157.70USD (kursi i këmbimit 0.9305788), nuk harmonizohet me transaksionin bankar. Nga një mos harmonizim i tillë i vlerës së dokumentacioneve të paraqitura nga pala paditëse, gjykata pranon konstatimet në arsyetimin e vendimit kontestues se paditësi nuk ka paraqit dokumentacion të kompletuar për të vërtetuar vlerën reale të mallit, në kuptim të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009.

Prandaj gjykata konstaton se paditësi nuk ka qenë në gjendje që ti provoj me argumente të bazuara pretendimet sekaparaqiturdokumentacionin e duhursipas të cilit do të duhejqë e padituraDogana e Kosovës ta vlerësontemallinlëndorsipasmetodëssëparë të vlerësimitneni 33 të KoditDoganordhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Si fakte vendimtare që kanë ndikuar që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe te Akcizave te Kosovës, gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës posedon të dhënat e disponueshme-dosja e vlerave. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas dosjes së vlerës.

Nga provat e administruara gjykata nuk ka gjetur fakte të bazuara qe argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale te mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit, prandaj gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga zyra e pranimit qëndror duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura ne procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e mjaftueshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr.07.3/77-2016 datës 23.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore te nenit 81.I par.2 pika 2.1 te Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.1554/19 datë 20.01.2021

G j y q t a r i,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit ne Prishtine, përmes kësaj gjykate.